



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 24 shtator 2012
Nr. ref.: RK301/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 20/12

Parashtruesi

Halim Hajredinaj

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës, A. nr. 590/2011, të 23 shtatorit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Halim Hajredinaj, nga fshati Stanovc i Epërm, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar gjyqësor është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), A. nr. 590/2011, i 23 shtatorit 2011, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 26 tetor 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës/lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) është çështja e njohjes së të drejtës për pension invalidor.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 dhjetorit 2009, i hyrë në fuqi më 15 janar 2010 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 28 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 1 mars 2012, Gjykata pranoi kërkesën e z. Halim Hajredinaj dhe e regjistroi atë me nr. KI 20/12.
6. Më 2 mars 2012, Kryetari, me vendimin GJR 20/12 caktoi gjyqtar raportues gjyqtarin Ivan Čukalović. Të njëjtën ditë, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova (anëtare) dhe Kadri Kryeziu (anëtar).
7. Më 11 maj 2012, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 25 maj 2012, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga Gjykata Supreme dëshmi përkitazi me datën e pranimit të Aktgjyqimit A. nr. 590/2011, të 23 shtatorit 2011, nga parashtruesi.
9. Më 7 qershor 2012, Gjykata Supreme dorëzoi përgjigjen në kërkesë dhe e informoi Gjykatën se parashtruesi e ka pranuar Aktgjykimin A. nr. 590/2011, të 23 shtatorit 2011, më 26 tetor 2011.
10. Më 19 shtator 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi Raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 6 nëntor 1989, Bashkësia Themelore e Sigurimit Pensional e Invalidor të Kosovës, në bazë të Aktvendimit nr. 7011636939, konstaton se te parashtruesi i kërkesës, për shkak të lëndimit në punë, ekziston invaliditeti i kategorisë së III-të. Organizata e Punës së Bashkuar ishte obliguar që parashtruesin e kërkesës ta sistemonte në ndonjë vend tjetër të punës që i përgjigjej aftësisë së tij për punë, të siguronte kompensim në të holla për lëndimin e pësuar në punë, dhe të siguronte mbrojtjen e të drejtave sipas kushteve dhe mënyrave që ishin të përcaktuara me aktivitetet e përgjithshme të kësaj organizate.

12. Më 6 nëntor 2007, ndërmarrja "Trepça", në bazë të Aktvendimit Nr-L 505, ia aprovon parashtruesit kërkesën për përfitimin e pensionit të parakohshëm.
13. Më 3 shkurt 2011, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejshëm: MPMS, përkatësisht Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, DAPK), në bazë të Vendimit me numër të dosjes 5098514, ia refuzoi kërkesën për përfitimin e pensionit për persona me aftësi të kufizuar, me arsyetimin se te parashtruesi i kërkesës nuk ekziston aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme.
14. Më 28 prill 2011, MPMS, përkatësisht DAPK, me Aktvendimin me nr. të dosjes 5098514, vendosi për ankesën e parashtruesit, me ç'rast ia refuzoi kërkesën për njohjen e të drejtës për pensionim të parakohshëm, duke u pajtuar kështu me vlerësimin e komisionit mjekësor, si shkallë e parë, që kishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk i plotëson kriteret për pensionim të personave me aftësi të kufizuar.
15. Më 1 korrik 2011, parashtruesi inicioi procedurë për konflikt administrativ në Gjykatën Supreme, kundër Aktvendimit me nr. 5098514, të 3 shkurtit 2011, të DAPK-së.
16. Më 23 shtator 2011, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin A. nr. 590/2011, duke vendosur sipas padisë së parashtruesit për konflikt administrativ, refuzoi padinë e ushtruar nga parashtruesi më 1 korrik 2011, me arsyetimin që komisionet mjekësore të autorizuara me ligj vërtetuan se te parashtruesi nuk ekziston aftësia e kufizuar për punë, prandaj, siç pohon Gjykata Supreme, organet administrative kanë zbatuar drejt dispozitën e nenit 3 të Ligjit për konfliktin administrativ.

Pretendimet e parashtruesit

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, me Aktgjykimin A. nr. 590/2011, të 23 shtatorit 2011, duke ia refuzuar përfundimisht të drejtën për njohjen e statusit të personit me aftësi të kufizuar, ka bërë shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, shkelje të cilat parashtruesi i kërkesës nuk i ka specifikuar në kërkesën e tij.
18. Parashtruesi i kërkesës kërkon, ndër të tjera, që t'i bëhet kompensimi në të holla për lëndimin e pësuar, për shkak të fatkeqësisë që i kishte ndodhur atij në vendin e punës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit duhet që, së pari, të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret procedurale për pranueshmëri, të parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe në Rregulloren e punës së Gjykatës.
20. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin A. nr. 590/2011 të Gjykatës Supreme, të 23 shtatorit 2011, të cilin, sipas librit të evidencës së Gjykatës Supreme, e ka pranuar më 26 tetor 2011. Ndërsa, kërkesën në Gjykatë, parashtruesi e parashtrroi më 1 mars 2012, që nënkupton se kërkesa është parashtruar jashtë afatit katër (4) mujor, të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës.
21. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që nënvizon:

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...]”

22. Nga ajo që u tha më lartë, del se parashtruesi e ka parashtruar kërkesën e tij jashtë afatit të paraparë me Ligj dhe Rregullore të punës së Gjykatës.
23. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit, me Rregullin 56. (2) të Rregullores së punës, kërkesa konsiderohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe me rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, më 19 shtator 2012, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t’u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues

Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

